



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 15.04.2013
Nr. 0204-297

PËR: Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes
Kujtim Xhelili, Kryesues i Kuvendit të Komunës Shtimes

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË SHTIMES,
NR. 01/43 të Pranuar me datë, 08.03.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me nenin 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.01/43 të miratuar me datën 28.02.2013 nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si vijon, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr.01/43 për caktimin e varrezave në lagjen Ademaj në fshatin Petrovë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 15.04.2013
Br. 0204-297

Za: Naim Ismajli, Gradonačelnik Opštine Štimlje
Kujtim Xhelili, Predsedvajući Skupštine Opštine Štimlje

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE ŠTIMLJE,
BR. 01/43 Priljeno dana, 08.03.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određeno po članu 82 Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu i dodatak XII Uredbe Vlade br.02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posla razmatranja Odluke br. 01/43 usvojene dana 28.02.2013 od Skupštine Opštine Štimlje, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu smoupravu br. 03/L-040.

Pravni Akt naveden u nastavku,ima puni pravni efekat .

- Odluka br. 01/43 za određivanje grollja u naselju Ademaj u selu Petrovo .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenikpremijera & Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava MALS-a
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/461, Datë: 22.2.2013



Npi – 01/43, Datë: 28.02.2013

Kuvendi Komunal- Shtime shqyrtoi kërkesën 01Nr.07/231 datë: 23.01.2013, të z.Nehat Ademaj, nga fshati Petrovë (Lagja Ademaj), i cili në emër të 24 nënshkruesve të kërkesës nga lagja Ademaj të fshatit Petrovë, ka kërkuar nga Kuvendi Komunal-Shtime, që ngastra kadastrale me numër, P-72809066-00481-0, me sipërfaqe prej 801 metër katror, të vendoset që të mbetet sipërfaqe e caktuar për varreza. Sipërfaqja gjendet në Zonën Kadastrale- Petrovë, e cila evidentohet pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime. Kuvendi Komunal pasi analizoi, kërkesën e palës, Rekomandimet e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Komitetit për Politik dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E VARREZAVE NË LAGJEN ADEMAJ TË FSHATIT PETROVË

I.

Kuvendi Komunal – Shtime, në mbledhjen e dytë, të rregullt për vitin 2013, të mbajtur më datën 28.2.2013, unanimisht ka vendosur që të aprovoi në parim kërkesën me numër 01Nr.07/231, të z.Nehat Ademaj, nga fshati Petrovë (Lagja Ademaj) që të mbetet sipërfaqe e caktuar për Varreza ngastra kadastrale, 00481-0, me sipërfaqe prej 801 metër katror, në Zonën Kadastrale- Petrovë, e cila evidentohet pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.

II.

A r s y e t i m: Kuvendi Komunal – Shtime, kërkesën e palës e ka aprovuar duke u bazuar në rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi me arsyetimin se aty në atë lokacion varrezat janë mbi 50 vite më parë, por që sipërfaqja duhet të definohet me vendim të Kuvendit dhe me matje gjeodezike.

III

Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe Ligjore për implementimin e këtij vendimi.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Kryetarit të Fshatit, dhe Imamit të Xhamisë në fshatin Petrovë.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili